

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ NATIONAL CONSTRUCTION” Sh.p.k.**

Shoqëria “DEUTSCHCOLOR” Sh.a, subjekt tregtar i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me Nipt L 21326504 J, përfaqësuar nga Administratori Z.Luan Muça atësia Shahin, lindur më 05/08/1971, me Leternjoftim ID nr.034346965 dhe nr.personal H10805062A

Në përputhje me vullnetin e saj të lirë dhe mbështetur në Ligjin me Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe me Ligjin me Nr. 131/2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” themeloi sot me datën 16.01.2024, shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “NATIONAL CONSTRUCTION” Sh.p.k me kushtet e mëposhtme:

Neni 1

Themeluesi Shoqëria “DEUTSCHCOLOR” Sh.a, do të krijojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të cilën do ta quajë “NATIONAL CONSTRUCTION” Sh.p.k.

Neni 2

Selia e Shoqërisë do të jetë në Tiranë, në adresën: Mëzez, Autostrada Tiranë- Durrës, Km1.5, Godina Delta, Zona Kadastrale 2679, nr.Pasurie 34/86, Mëzez Tiranë. Me vendim të Ortakëve mund të hapen degë, filiale ose përfaqësi, brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Neni 3

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj me një afat të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj dhe në statutin e shoqërisë, ose me vendim të Ortakëve.

Neni 4

Organet Drejtuese të Shoqërisë janë: Ortakët e Shoqërisë.
Administratori i kësaj shoqërie është Z.Luan Muça, i biri i Shahin dhe i Kadine, i datëlindjes 05.08.1971, lindur në Elbasan dhe banues në Tiranë, Rruga “Vilave”, i identifikuar me leternjoftim nr. 038371587 dhe Nr. Personal H10805062A.

Neni 5

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj :

Projektim dhe ndërtimi i objekteve civile apo industriale dhe menaxhimi i zbatimit të projekteve të kësaj natyre për vete dhe për të treta; b.Investimin në projekte zhvillimi zonash urbane, turistike apo rezidenciale apo investime të cilësdo natyre qoftë në zhvillimin e pasurive të paluajtshme në përgjithësi; c. Shitja e njësive të gjeneruara nga investimet në projekte të zhvillimit të pasurive të paluajtshme apo shitja e projekteve të zhvillimit në veçanti; d.Administrimi dhe shfrytëzimi i njësive të gjeneruara nga investimet në projektet e zhvillimit në zonat e turizmit për qëllime rekreative dhe akomoduese; e. Ofrimi i shërbimit të konsulencës në



fushën e biznesit, menaxhimit, taksave etj. f. Vlerësim të pasurive të paluajtshme. Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë cdo lloj veprimtarie apo trasaksion tjetër që lidhet me pasuri të luajtshme e të paluajtshme, me kryerjen e veprimeve tregtare, industriale, bankare dhe/ose financiare të cfarëdo lloji dhe natyre, të nevojshme ose të dobishme për arritjen dhe ose plotësimin e objektivit të Shoqërisë, që nuk ndryshon aktivitetin parësor të Shoqërisë dhe nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Mund të lidhë kontrata të dyanshme aktivi dhe pasivi me institutet e kreditit të autorizuara nga ligji dhe me shoqëritë dhe firmat private, të japë garanci reale edhe për të tretët dhe gjithcka që është e nevojshme për realizimin e objektivit të veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 6

Kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë 100.000 (njëqind mijë euro) Euro.

Neni 7

Kapitali themeltar është depozituar prej tij në një llogari të hapur në emër të shoqërisë “NATIONAL CONSTRUCTION” Sh.p.k në formim e sipër.

Neni 8

Shoqëria do të rregullohet, përveç këtij akti themelues edhe me norma të përcaktuara në Statutin e saj dhe në dispozitat e Ligjit me Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe të Ligjit me Nr. 131/2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”

Neni 9

Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) ekzemplarë, në gjuhën shqipe duke patur secili ekzemplar fuqi të njëjtë ligjore.

THEMELUESI

Shoqëria “DEUTSCHCOLOR” Sh.a

Administratori

